
	<b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b> REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA <b>KOMUNA E RAHOVECIT</b> OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

<b>Për:</b>	<b>Operatorë Ekonomik: MENDI INVEST SH.P.K.</b> me adresë në <b>Klinë</b> <b>Operatorëve Ekonomik</b> <b>Të gjitha palëve të interesuar</b>
<b>Nga:</b>	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
<b>Lënda:</b>	<b>VENDIM</b> për Rishqyrtim të Kërkesës
<b>Datë:</b>	<b>29.04.2024</b>

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **27.04.2024** në Ora: **14:16 h**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **MENDI INVEST SH.P.K.** me adresë në **Klinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RIPARIME NË NËNTË (9) SHKOLLA FILLORE DHE TË MESME TË LARTA**, me Numër të prokurimit: **623-24-3635-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-037-5-2-1**, nxjerr:

### VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **MENDI INVEST SH.P.K.** me adresë në **Klinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RIPARIME NË NËNTË (9) SHKOLLA FILLORE DHE TË MESME TË LARTA**, me Numër të prokurimit: **623-24-3635-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-037-5-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **17.04.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **RIPARIME NË NËNTË (9) SHKOLLA FILLORE DHE TË MESME TË LARTA**, me Numër të prokurimit: **623-24-3635-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-037-5-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

## A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik: **MENDI INVEST SH.P.K.** me adresë në **Klinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RIPARIME NË NËNTË (9) SHKOLLA FILLORE DHE TË MESME TË LARTA**, me Numër të prokurimit: **623-24-3635-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-037-5-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **17.04.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **27.04.2024** në Ora: **14:16 h**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

### BAZA LIGJORE E KËRKESËS

#### PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

shprehur interesim të marrim pjesë mirepo pas analizimit të kriterëve kemi verjetur që ka kritere diskriminuese të panevojshme të cilat e kufizojnë në masë të madhe pjesëmarrjen dhe na e pamundësojnë edhe neve poashtu që të marrim pjesë në këtë aktivitet prokurimi.

Tek kërkesa 9.1 & 9.2 pra të stafi profesional Inxhinieret, ku kërkohet që kontrata e punës ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt të jetë e noterizuar në prezencë të paleve është kriter diskriminues dhe shumë absurd kur ofrohet marrëveshja ose kontrata e punës në origjinal pse duhet të jetë e noterizuar kur noterizimi nuk do të thotë vërtetësim i një dokumenti, noteri kur e noterizon një dokument qfar do qofte ai shembull në këtë rast kontrata e punës nëse noterizohet në faqen mbrapa shkruan që palet kanë sjellur një dokument të quajtur kontratë pune në mes të OE dhe Inxhinierit të cilët kanë nënshkruar në prezencë timen dhe për përmbajtjen e dokumentit noteri nuk mban përgjegjësi atëherë shtrohet pyetja pse duhet të kërkohen dokumente të tilla të noterizuara?!

Ky kriter është poashtu favorizues për një OE të caktuar, ky kriter duhet të hiqet nga kushtet e dosjes së tenderit pasi që e kufizon në masë shumë të madhe pjesëmarrjen e OE të tjere.

Nëse nuk largohet atëherë do të vazhdojmë të ndjekim të drejtën tonë ligjore në organe me të larta kompetente.

Poashtu edhe tek kërkesa e stafit teknik për punëtorët ku kërkohet që të jetë e noterizuar kontrata e punës vlen e njëjta gjë ashtu siq e cekem më lartë kjo kërkesë është diskriminuese dhe duhet të largohet menjëher nga dosja e tenderit.

---

#### PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

**Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr.1 nuk qëndron.**

**Autoriteti Kontraktues** qëndron prapa kësaj kërkesë dhe nuk do të largoj të njëjtën nga Dosja e Tenderit, për arsye të përvojës së keqe që ka në raste të caktuara në Aktivitete të Prokurimit.

Në c ‘rast Operatori Ekonomik ofertojnë me inxhinierë të cilët në fakt nuk jetojnë brenda vendit dhe veprimtarinë e tyre e ushtrojnë jashtë vendit ose edhe i njoftojnë AK që OE pa aprovimin e tyre i ka vendosur në listë të stafit. Pra për shkak të verifikimit dhe dëshmisë që personat e tillë janë në listë të stafit me pajtim ose marrëveshje të tyre është vendosur dhe vazhdon të vendoset kërkesa e tillë.

## **PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:**

Pastaj tek Aneksi 8 lista e paisjeve dhe mekanizmi i obligueshem:

Kamion me lift me peshe maksimale 840 ky kriter eshte diskriminues favorizues per nje OE te caktuar dhe i pa nevojshem sepse ne asnjerin prej pozicioneve nuk nevojitet per realizimin e tyre. duhet te hiqet menjeher nga lista e paisjeve te obligueshme.

Laser prerës qeramike - ne si OE kemi maqinat per prerjen e pllakave deri ne 1.60m te cilat nuk jan me laser por e kan funksionin e njejt dhe pllaken mund ta prejme ashtu si me laser prandaj edhe ky kriter eshte diskriminues dhe favorizues per nje OE te caktuar - duhet te hiqet menjeher nga kriteret.

---

## **PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:**

**Pretendimi ankimor te kërkesat** mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale gjithashtu nuk qëndron ngase përcaktimi i kësaj për pajisjet dhe mekanizimin, është kërkesë që ka të bëjë lëndën së natyrës së Projektit në fjalë, dhe gjithashtu një kërkesë e tillë është e domosdoshme për Aktivitetin e Prokurimit në fjalë.

Bazuar në të dhënat e lartë përmendura, Autoriteti Kontraktues gjatë përcaktimit të kërkesave dhe dëshmimeve është kujdesur që në maximum ti respektoj parimet thelbësore të përcaktuara me LPP siç janë, **Konkurrenca, Trajtimi i barabarte dhe jo diskriminim**. Gjithashtu Autoriteti Kontraktues është kujdesur që të vendos vetëm kërkesa dhe dëshmi **në pajtueshmëri me objektin e kontratës. Kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit dhe në njoftimin për Kontratë sa i përket Kërkesave dhe dëshmimeve mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale** janë vendosur gjithashtu duke u bazuar plotësisht në nenin 69 paragrafin 6.1 dhe paragrafin 6.4 të Ligjit të Prokurimit Publik Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

### **Vendimi Publikohet:**

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi  
Menaxher i Zyrës se Prokurimit  
Komuna e Rahovecit